



Pranimi / Primesha / Received / Prezent	17.01.2022	2	viti / god / year
Organ dhe shtet / Organ / State / Org / Staat	SKDMSHCK	178/2022	115
Titulli / Titoli / Title / Titel			
Shtesa / Prilog / Appendix			
Sasia / Kolicina / Quantity			



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO**

A nr.1000/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës- Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti -kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabani -anëtarë, si dhe Sabile Avdyli-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1000/2021 të datës 03.12.2021 të parashtruar nga ankuesja me adresë: banimi

Prishtinë , kundër organit të punësimit Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, në çështjen juridike “Kontestim Konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 17.01.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. REFUZOHET si e pabazuar ankesa me numër A.nr. 1000/2021 e datës 03.12.2021 e parashtruar nga ankuesja
- II. MBETET në fuqi Vendimi me numër KA.nr.56/2021 i datës 26.11.2021 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

A r s y e t i m

Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, me datë 26.04.2021 ka shpallur konkursin për pozitën “Përkthyes shqip -serbisht dhe anasjelltas” -në Gjykatën Themelore në Gjilan -dega në Novobërd”, në të cilin konkurs ka aplikuar edhe ankuesja Selvete Borovci, e cila është ftuar të marrë pjesë në testin me shkrim dhe intervistën me gojë mirëpo nuk është përzgjedhur si kandidatë i suksesshëm për këtë pozitë.

Më datën 26.10.2021 Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës ka publikuar njoftimin për kandidatin e suksesshëm me numër:03/1734 për pozitën “Përkthyes shqip -serbisht dhe anasjelltas” -në Gjykatën Themelore në Gjilan -dega në Novobërd” .

E pakënaqur me njoftimin e datës 26.10.2021, ankuesja më datë 27.10.2021 ka parashtruar ankesë me numër protokoll 01/1742 në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës më datë 26.11.2021 nxjerr Vendimin me numër KA.nr.56/2021 i protokolluar me nr.01/1885 me të cilin ka refuzuar si të pabazuar ankesën e ankueses.

Ankuesja kundër Vendimit me numër KA.nr.56/2021 të datës 26.11.2021 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, më datë 03.12.2021 ka parashtruar ankesën me numër protokoll 5791/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me pretendimet ankimore se procedura e rekrutimit lidhur me konkursin e lartë cekur është zhvilluar në kundërshtim me legjislacionin në fuqi për shërbimin civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 07.12.2021, ankesën e ankueses e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Sekretari i Këshillit Gjyqësor të Kosovës më datë 14.12.2021 ka dërguar në Këshill përgjigjen në ankesë me shkresat e procedurës së zhvilluar me provat e bashkangjitura të lëndës dhe është protokolluar me numër:6090/2021.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën e datës 03.12.2021 me numër protokoll 5791/2021 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Ankesë e datës 27.11.2021 me numër protokoll 1742 e parashtruar në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës; Vendimi me numër KA.nr.56/2021 i datës 26.11.2021 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës; Përgjigje në ankesë e datës 14.12.2021 nga organi i punësimit me numër protokoll 6090/2021 bashkë me provat e lëndës; Njoftimi për përzgjedhjen përfundimtare i datës 26.10.2021 me numër protokoll 1734; Propozim për emërimin e kandidatit të rekomanduar i datës 26.10.2021; Përcaktimi i kriterëve për testin me shkrim dhe me gojë i datës 19.10.2021; Renditja përfundimtare e kandidatëve e datës 19.10.2021; Përmbledhja e vlerësimeve individuale e datës 19.10.2021; Raporti final i rekomandimit nga Komisioni Rekrutues i datës 19.10.2021; Regjistri i aplikacioneve të pranuar i datës 15.10.2021; Vendimi i datës 12.10.2021 me nr.ref.DS-568/2021; Propozim për emërimin e KPSHC-së i datës 12.10.2021; Deklarat e datës 12.09.2021; Raport mbi përgatitjen e listës së ngushtë i datës 15.10.2021 për

Deklaratë për mosekzistimin e konfliktit të interesit i datës 15.10.2021 për

Deklaratë për mosekzistimin e konfliktit të interesit i datës 15.10.2021 për

Deklaratë për mosekzistimin e konfliktit të interesit i datës 15.10.2021 për Testi me shkrim; Shpallja e konkursit të jashtëm me Nr.02/2021 e datës 26.04.2021 në SKGJK; Kërkesë për autorizimin e konkursit i datës 26.04.2021; Vendimi i datës 19.08.2021 për anulimin e konkursit;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të dërguara nga ankuesja dhe organi i punësimit, ka konstatuar se ankesa e ankueses **është e pabazuar, sepse:**

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, gjatë shqyrtimit dhe analizimit të provave të ofruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, më datën 26.10.2021 ka publikuar njoftimin për kandidatin e suksesshëm me numër:03/1734 për

pozitën "Përkthyes shqip -serbisht dhe anasjelltas" -në Gjykatën Themelore në Gjilan -dega në Novobërd".

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka konstatuar se pretendimi ankimor i ankueses se dyshon në numërimin e pikëve të intervistës me gojë e mbajtur me datën 19.10.2021 nga Komisioni Përzgjedhës është i paqëndrueshëm sepse është konstatuar se ankuesja znj.

kishte arritur 65 pikë, ndërsa në listën përfundimtare kishte arritur 293.5 pikë, për dallim nga kandidati fitues i cili në listën përfundimtare kishte arritur më tepër pikë se ankuesja në listën përfundimtare, pra kishte arritur 334 pikë. Kriteret e konkursit për pozitën "Përkthyes shqip -serbisht dhe anasjelltas" -në Gjykatën Themelore në Gjilan -dega në Novobërd", kanë qenë:

"Diplomë Universitare dhe Dy (2) vite përvojë pune profesionale".

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, gjatë analizimit të shkresave të lëndës të ofruara nga palët në procedurë, shqyrtuar pretendimet ankimore të ankueses e cila dyshon se gjatë intervistës me gojë e mbajtur me datë 19.10.2021 për pozitën "Përkthyes shqip -serbisht dhe anasjelltas" -në Gjykatën Themelore në Gjilan -dega në Novobërd", Komisioni Përzgjedhës i Shërbimit Civil nuk e ka vlerësuar ankuesen meritorisht është bazuar vetëm te neni 40.1 dhe neni 28 paragrafin 1 dhe 2 të Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka konstatuar se ky pretendim i ankueses është i pabazuar Komisioni Përzgjedhës i Shërbimit Civil ka vepruar në pajtueshmëri me dispozitat e Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil neni 28 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe 1.2 i cili ka përcaktuar se: *"1.Anëtarët e KPSHC-së vlerësojnë aplikacionet në bazë të kriterëve në vijmë:1.1 Arsimiti dhe kualifikimi profesional; si dhe 1.2. përvoja e punës"* pasi që ka vlerësuar drejtë përmbushjen e kriterëve të konkursit nga kandidatët e lartcekur. Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave gjatë shqyrtimit të shkresave të lëndës ka konstatuar se ankuesja në testin me shkrim ka arritur (65) pikë, andaj me rastin e ftesës për intervistim me gojë Komisioni Përzgjedhës ka vepruar në pajtim me nenin 36 paragrafi 2 ku përcaktohet se: *"Kandidatët të cilët e kalojnë me sukses testimin me shkrim dhe arrijnë të mbledhin së paku 50 % të maksimumit të pikëve të përcaktuara nga KPSHC pranohen të hyjnë të testit me gojë...."*. Po ashtu, Kolegji gjatë analizimit të formularëve të datës 19.10.2021 në të cilët evidentohen pikët e testit me shkrim dhe vlerësimit të intervistës me gojë është konstatuar se ankuesja është vlerësuar nga të gjithë anëtarët edhe në fushën e kriterëve të përzgjedhjes siç janë: *"Personaliteti dhe Planet Profesionale; Njohuritë e Përgjithshme Institucionale dhe Ekonomike; Njohuritë që Lidhen me vendin e Punës"* siç përcaktohet edhe me dispozitat e Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil neni 38 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, 1.2 dhe 1.3 se: *"Kandidatët të cilët kalojnë me sukses testimin me shkrim i nënshtrohen testimit me gojë, e cila përbehet prej këtyre pjesëve: 1.1 Personaliteti dhe Planet Profesionale; 1.2 Njohuritë e Përgjithshme Institucionale dhe Ekonomike dhe 1.3 Njohuritë që Lidhen me vendin e Punës"*, andaj mbi bazën e këtyre fakteve Komisioni Përzgjedhës ka kryer detyrat e përcaktuara në nenin 7 paragrafin 7 të Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në bazë të raportit të datës 19.10.2021 për renditjen përfundimtare të kandidatëve, ka konstatuar se kandidati i përzgjedhur si më i vlerësuar është me 334 pikë, ndërsa ankuesja është renditur e treta me 293.5 pikë, me çka konstatohet se ankuesja nuk ka arritur pikët maksimale që të jetë në mesin e kandidatëve të përzgjedhur siç përcaktohet me dispozitat e Rregullores Nr.02/2010 të Rekrutimit në Shërbimin

Civil neni 40 paragrafi 1 ku përcaktohet se: *"Në shërbimin civil emërohen kandidatët, të cilët kanë arritur numrin më të madh total të pikëve në testimin me shkrim dhe me gojë"*.

Andaj mbi bazën e të gjeturave si më lart, Kolegj për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka konstatuar se procedura e rekrutimit për pozitën "Përkthyes shqip -serbisht dhe anasjelltas" -në Gjykatën Themelore në Gjilan -dega në Novobërd" e shpallur me konkursin Nr: 02/2021 të datës 26.04.2021 nga Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, është zhvilluar në pajtueshmëri me dispozitat e Ligjit Nr.03-L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës neni 11 paragrafi 1 i cili përcakton se: *"Pranimi në Shërbimin Civil të Kosovës bëhet në pajtim me parimet e meritës, aftësisë profesionale, paanshmërisë, mundësive të barabarta, mos diskriminimit dhe përfaqësimit të barabartë, në bazë të konkursit publik dhe pas verifikimit të zotësisë së veprimit të kandidatëve"* si dhe nenin 18 paragrafi 1 i të njëjtit ligji i cili përcakton se: *"Pranimi në Shërbimin Civil mbështetet në parimet e meritës, me shpallje publike të pozitave të lira, me transparencë të procesit, me objektivitet dhe paanësinë e komisionit testues, mos diskriminimin e kandidateve dhe të drejtën për t'u ankuar në fund të procedurës"*, ndërsa ankesa e ankueses është e pabazuar në tërësi dhe si e tillë është refuzuar.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka konstatuar se Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës me datë 26.10.2021 me numër protokolli 1734, ka publikuar njoftimin lidhur me përzgjedhjen përfundimtare të kandidatit për pozitën e punës "Përkthyes shqip -serbisht dhe anasjelltas" -në Gjykatën Themelore në Gjilan -dega në Novobërd", sipas të cilit njoftim është poentuar si kandidati i parë me gjithsej 334 pikë, ndërsa ankuesja në këtë rast ka qenë aplikuese dhe nuk ka arritur numrin e pikëve për tu përzgjedhur, andaj Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka konstatuar se përzgjedhja e kandidatit më të suksesshëm për pozitën "Përkthyes shqip -serbisht dhe anasjelltas" -në Gjykatën Themelore në Gjilan -dega në Novobërd" është zhvilluar në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, me rastin e nxjerrjes së Vendimit numër KA.nr.56/2021 të datës 26.11.2021, ka vepruar në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe Rregulloren Nr. 05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe të Ankesave, sepse ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda me A.nr.1000/2021, 17.01.2022

Sabile AVDYLI

Sabile Avdyli

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Vendimi i dërgohet

- Ankueses,
- Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së

